



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSIS DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA QENDRORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____. 2023

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” Shpk

Adresa: Rruga “Siri Kodra”, Ndërtesë 2-katëshe, me zonë kadastrale 8340 dhe numër pasurie 8/660, kati 1, Njesia Bashkiake Nr. 8, Tiranë

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur - prokurim me mjete elektronike - mallra. Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12-mujore.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Unite dentare për kujdesin dentar te fëmijët”, për një periudhë 12-mujore.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave: 16,632,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Numri i Referencës: REF-63020-03-20-2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. TRIMED Sh.p.k

K51612031J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera e ofruar 11,608,470 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. Fedos – Uppsala Sh.p.k L92119028Q
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t

Vlera e ofruar 14,040,000 (katërbëdhjetë milion e dyzet mijë) lekë pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. Farma Net Albania Shpk K92201080V
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t

Vlera e ofruar 15,544,080 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. TRIMED Sh.p.k K51612031J
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t

Arsyet

- Nuk plotëson Pikën 2.3.1, të Shtojcës 7.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” , pasi faturat e paraqitura nga OE nuk konsiderohen si mallra të ngjashëm objekt procedure(Unite Dentare), rrjedhimisht duke mos arritur as vlerën e kërkuar sipas kriterit.
- Operatori ekonomik për plotësimin e pikës 2.3.5 (*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për unitet dentare objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo produkti që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Përshkrimi teknik/specifikimet teknike të kërkuara në DST duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.**) ka dorëzuar në SPE manual përdorimi, në të cilin evidentohen mangësi në të dhëna ,konkretisht (paparashikuara,pamarkuar dhe/ose papërkthyer dhe/ose panoterizuar) për disa nga specifikimet teknike të kërkuar si dhe disa prej specifikimeve teknike gjenden në një deklaratë dorëzuar nga OE*
- Gjithashtu është konstatuar në manualin e dorëzuar se disa nga parametrat e specifikimeve teknike nuk përmbushin kërkesat e DST.

Specifikimet teknike të konstatuara do të listohen me poshtë sipas rradhës së parashikuar në Dst së bashku me vlerësimet e KVO-së

2.SPECIFIKIME TEKNIKE

A. Çdo unit duhet të jetë i pajisur me aspiratorin kirurgjikal ku:

- Niveli i zhurmave i lejuar sipas DST: 62 dB
- Niveli i zhurmës sipas manualit të dorëzuar nga OE - 69 dB

*Parametrat e Specifikimi Teknik janë mbi vlerën e lejuar sipas DST

B. Tavolina e instrumentave / krahu i punës.

- Tavolina e instrumentave e pozicionuar për së larti.
- Duhet të jetë e lidhur me njësinë qendrore nëpërmjet krahut "pantografik" me panel kontrollues.

-Duhet të ketë të paktën 5 dalje, me dalje ajër-ujë.

Specifikimet teknike të sipërcituara për 'Tavolina e instrumentave/krahu I punës' gjenden të markuara në manual por të pa përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi dhe pa noterizuar sipas kërkesave të DST.

B.2

Sipas DST -Mikromotor i aftë për të performuar 20.000 - 40.000 rr/min me kontra angel.

Sipas Manualit të dorëzuar nga OE - Mikromotor i aftë për të performuar max 20.000 rr/min Mikromotori ka si vlerë maksimale performimi të tij vlerën minimale të parashikuar nga DST duke mos përmbytur parametrat e kërkuar

B.3 Kaviron i inkorporuar në poltron.

Kaviron (pastrim gurzash) Pastrues gurzash me ultratinguj i brëndshëm, i cili montohet në unit dhe punon i varur prej tij, ndizet me këmbë, kontrollohet sasia e ujit të nxjerrë gjatë punës.

Gjendet i pjesshëm si përshkrim në manual

Mënyra e funksionimit - e vazhdueshme; të mundësoj sterilizimin

Specifikimi Teknik nuk gjendet i parashikuar në manualin e përdorimit të dorëzuar nga OE

C. Llambë

- Duhet të jetë e lidhur me njësinë qendrore nëpërmjet krahut "pantografik"*
- Distanca minimale e fokusimit 1 m*

Specifikimet Teknike të sipërcituara në pikën E. "Llambë" nuk gjenden të parashikuara në manualin e përdorimit të dorëzuar nga OE

D.KRAHU I ASISTENTIT

- Me 4 dalje*
- Shiringa ujë- ajër- spraj e asistentit*
- Të jetë e pajisur me Kanjula për aspirim të thjeshtë*
- Të jetë e pajisur me Kanjula për aspirim kirurgjikal (e lidhur me aspiratorin kirurgjikal)*
- Duhet të jetë e lidhur me njësinë qendrore nëpërmjet krahut të 2 "pantografik"*
- Paneli komandues të pranojë solucionet dezinfektuese e të mos dëmtohet.*

Specifikimet Teknike për pikën D. "krahu i asistentit" nuk gjenden të parashikuar në manualin e përdorimit të dorëzuar nga OE por vetëm të përkthyer.

E.PEDALI I KONTROLLIT QËNDROR

- Të jetë e çmontueshme për dezinfektimin dhe shpëlarjen e vazhdueshme.*
- E pajisur me aparat shpëlarje.*
- E pajisur me rezervuar të veçantë uji dhe dezinfektimi.*
- Të jetë e rrotullueshme dhe komode për pacientin.*
- Të ketë filtër uji të çmontueshëm.*

Specifikimet Teknike të sipërcituara për pikën E "PEDALI I KONTROLLIT QËNDROR" nuk gjenden të parashikuar në manualin e përdorimit të dorëzuar nga OE.

Poltroni duhet të jetë patjetër i pajisur me Kompresor ajri i cili duhet të jetë:

-Fuqia e kërkuar sipas DST: Minimalisht 2.0 HP (kuaj fuqi) /1.4 kw

-Fuqia e paraqitur në manual : 1.1 Kw

*Pasi u konvertua nga ana jonë rezulton se fuqia e kompresorit është më e ulët se fuqia e kërkuar duke mos përmbushur parametrat e parashikuar nga DST.

F. Karrigia

-E veshur me lëkurë ose imitim

-E vendosur në rrota rezistente.

-E pajisur me piston për të kryer lëvizje poshtë e lartë dhe lëvizjen e shpinores lart-poshtë.

-Të jetë komode për mjekun

Specifikimet Teknike e sipërcituara në pikën F “**Karrigia**” nuk gjenden të parashikuar në manualin e përdorimit të dorëzuar nga OE.

H. Tavolinë Instrumentash / medikamentesh

-Të ketë dy doreza të vendosura në anësore për zhvendosjen e saj

-Të jetë me material që pranon solucionet dezinfektuese.

Specifikimet Teknike e sipërcituara në pikën H “Tavolinë instrumentash/medikamentesh” nuk gjenden të parashikuar në manualin e përdorimit të dorëzuar nga OE.

2. Fedos – Uppsala Sh.p.k

L92119028Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet

- Nuk plotëson Pikën 2.3.1, të Shtojcës 7.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi nuk plotësohet vlera e kërkuar sipas DST .Faturat e dorëzuara nuk japin detaje bashkëlidhur ku mund të evidentohen artikujt e prokuruar në këto kontrata ku mund të përcaktohet edhe vlera e kërkuar sipas kriterit. Konkretisht fatura me emërtimin Dental Care Mobile Unit, 2 copë (automjet & unit/ njësi lëvizëse) e cila nuk është e detajuar se çfarë pjesë të faturës zënë unitet dhe çfarë pjesë zë makina e lëvizshme. Shpjegojmë se në DST kontrata e ngjashme i referohet objektit të procedurës "Unite dentare për fëmijë", dhe si rrjedhojë nuk i referohemi pjesës që zë makina lëvizëse por vetëm pjesës që zë Unitin. Unitin Dentar zë një pjesë të vogël të këtij seti, dhe nga ana e OE sasia 2 cope/ set Dental Care Mobile Unit e paraqitur në ofertë është e pamjaftueshme, dhe si rrjedhim nuk plotësohet vlera e kërkuar sipas DST Kerkesat e Vecanta per Kualifikim, Pika 2.3.1. Kapaciteti Teknik, shtojca 7.2.
- Operatori ekonomik për plotësimin e pikës 2.3.5 (*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për unitet dentare objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo produkti që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Përshkrimi teknik/specifikimet teknike të kerkuara në DST duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar.**) ka dorëzuar në SPE manual përdorimi ,në të cilin evidentohen mangësi në të dhëna ,konkretisht (pamarkuar,pa përkthyer dhe/ose pa noterizuar) për disa nga specifikimet teknike të kërkuar .*
- Gjithashtu është konstatuar se në brendësi të manualin të dorëzuar gjenden të mbivendosura etiketime dhe/ose shkrime në gjuhën shqipe ,faqe në brendësi të manualit të printuara nga website me orë dhe datë si dhe një pjesë e konsiderueshme e specifikimeve gjenden në deklaratë të paraqitur nga OE .
- Specifikimet teknike të konstatuara do të listohen me poshtë sipas rradhës se parashikuar në Dst së bashku me vlerësimet e KVO-së

1. SPECIFIKIME TEKNIKE

B. Tavolina e instrumentave / krahu i punës.

-Tavolina e instrumentave e pozicionuar për së larti.

Specifikimi Teknik gjendet i referuar(foto) por i pamarkuar ne manual dhe i pa përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi dhe i pa noterizuar sipas kërkesave të DST.

- *me dritë të autoklavueshme disa herë,*

Nuk gjendet i markuar, specifikimi teknik i mbivendosur ne manual ne gjuhen shqipe.

- *Shpejtësia maksimale e xhirove jo më pak se 300.000 rr/min; Shpejtësia minimale e xhirove jo më pak se 20.000 rr/min. (e pajisur me angël)*

Specifikimi Teknik për shpejtësinë minimale nuk gjendet i markuar ne manual sipas kërkesave të DST .

B.3 Kavatron i inkorporuar në poltron.

- *Pjesamenti i autoklavueshem; i ndërrueshëm, me pesë koka, me çelës i shoqeruar me 5 (pesë) koka.*

Specifikimi Teknik për pikën B.3 “Kavatron i inkorporuar në poltron” nuk gjendet i përkthyer në gjuhën shqipe sipas kërkesave të DST,pra me vërtetim përkthimi dhe i noterizuar .

C. Llambë

- Duhet të jetë e lidhur me njësinë qendrore nëpërmjet krahut "pantografik”

- Të jetë jo e dëmtueshme për sytë e pacientit

Specifikimi Teknik të sipërcituara në pikën C “Llambë” nuk gjendet i markuar në manual sipas kërkesave të DST .

D.KRAHU I ASISTENTIT

Me 4 dalje

Shiringa ujë- ajër- spraj e asistentit

Të jetë e pajisur me Kanjula për aspirim te thjeshtë

Të jetë e pajisur me Kanjula për aspirim kirurgjikal (e lidhur me aspiratorin kirurgjikal)

Duhet të jetë e lidhur me njësinë qendrore nëpërmjet krahut të 2 "pantografik”

Panel komandues për poltronën, pështymoren dhe gotën e ujit

Paneli komandues të pranojë solucionet dezinfektuese e të mos dëmtohet.

Nuk gjendet i markuar sipas kerkesave të DST, specifikimi teknik vetem foto dhe mbivendosur ne manual ne gjuhen shqipe

H.Tavolinë Instrumentash / medikamentesh

Të ketë dy doreza të vendosura në anësore për zhvendosjen e saj

Specifikimi Teknik nuk gjendet i markuar ne manual.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Farma Net Albania Shpk, me NIPT K92201080V, me adresë: Rruga “Siri Kodra”, Ndërtesë 2-katëshe, me zonë kadastrale 8340 dhe numër pasurie 8/660, kati 1, Njesia Bashkiake Nr. 8, Tiranë, me një vlerë të përgjithshme prej 15,544,080 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, me adresë “Rruga e Dibrës”, nr.12, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR